

LIGJ
Nr. 46/2017

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7764, DATË 2.11.1993, “PËR INVESTIMET E
HUAJA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Dispozitë kalimtare

1. Mbrojtja e posaçme shtetërore, në kuptim të këtij ligji, do të jepet deri më 31 dhjetor 2018.
2. Mbrojtje të posaçme shtetërore, sipas parashikimeve të neneve 8/b, pikat 1 e 2, 8/d dhe 8/dh, të këtij ligji, përfitojnë automatikisht dhe pa pasur nevojën e ndjekjes së ndonjë procedure apo marrjes së ndonjë vendimi tjetër edhe investitorët/investimet strategjike, procedurë e veçantë, që kanë marrë këtë status, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Ministrave përcakton kufijtë dhe tagrat e zëvendësimit të palëve, në përputhje me nenin 8/b të këtij ligji.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10216, datë 27.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani